



A.nr.120/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.120/2026, të datës 02.02.2026, të parashtruar nga ankuesja G.L. nga Prishtina, në çështjen juridike – administrative “*transferim i përkohshëm*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 06.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr. 120/2026, e datës 02.02.2026, e parashtruar nga ankuesja G.L. **Anulohet** Vendimi me Nr. T-05/2025, i datës 06.01.2026, i Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës.
- II. Obligohet** Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit të Konkurrencës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, ta kthejë ankuesen në vendin e punës sipas aktit të emërimit Nr. AE-19/2025, të datës 18.06.2025, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.
- III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja G.L. (*tutje referuar ankuesja*), më datë 30.01.2026, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 02.02.2026, nën shenjën A.nr.120/2026, kundër Vendimit me Nr. T-05/2025, të datës 06.01.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Autoritetin e Konkurrencës, ndërsa, ky i fundit, ka dhënë përgjigje në pretendimet ankimore duke bashkangjitur edhe provat materiale ndërlidhur me çështjen në procedurë **Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 554/2026 të datës 02.02.2026 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emailin e datës 28.01.2026 nga N.B për N.O dhe K.S; Emailin e datës

28.01.2026 nga N.O për N.B; Emailin e datës 28.01.2026 nga K.S për N.B; Emailin e datës 28.01.2026 nga ankuesja për S.B, N.B, K.S dhe N.O; Emailin e datës 28.01.2026 nga S.B për G.L, N.B; Emailin e datës 27.01.2026 nga ankuesin për N.B, K.SM N.O; Emailin e datës 27.01.2026 nga S.B për E.T, R.A, A.GJ, F.Z, B.B, Sh.E dhe G.L; Emailin e datës 06.01.2025 nga S.B për A.F, G.L, M.M, Sh.B dhe Sh.E; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore datës 22.08.2025 dhe 28.01.2026 ndaj ankueses; Emailin e datës 23.01.2026 nga A.R për N.B, S.B dhe E.T; Emailin e datës 22.01.2026 nga N.B për S.B, A.R dhe E.T; Emailin e datës 22.01.2026 nga ankuesja për N.B, K.S dhe N.O; Emailin e datës 22.01.2026 nga ankuesja për E.T; Përgjigje në këse e datës 23.04.2025; Kërkesën për ndërrim të divizionit e datës 15.08.2024 nga ankuesja; Propozim lidhur me kërkesën për pezullim të Drejtorit të Sekretarit të AKRK-së datës 05.05.2025; Kërkesën e datës 22.04.2025; Kopjen e ID-së së ankueses; Vendimin A.nr.2033/2024 të KPMSHCK-së; Emailin e datës 26.01.2026 nga ankuesja për A.R; Vendimin Nr. T-05/2025 të datës 06.01.2026, për transferimin e përkohshëm të ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.02.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 10.02.2026; Akt Emërimit Nr. AE-19/2025 të datës 18.06.2025.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, sepse:

I. Gjendja e fakteve

Nga administrimi i provave materiale rezulton se:

- Ankuesja sipas Aktit të Emërimit me Nr. AE-19/2025, të datës 18.06.2025, është e punësuar në pozitën Inspektor Hetues i Konkurrencës, në Departamentin e Marrëveshjeve të Ndaluara, në kuadër të Autoritetit të Konkurrencës.
- Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës më Vendimin me Nr. T-05/2025, të datës 06.01.2026, ka bërë transferimin e përkohshëm të ankueses nga pozita Inspektore Hetuese e Konkurrencës në Divizionin e Marrëveshjeve të Ndaluara në pozitën Inspektore Hetuese e Konkurrencës në Divizionit e Analizës, Metodologjisë dhe të të Drejtave Ekskluzive.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin me Nr.T-05/2025, të datës 06.01.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, duke pretenduar se ndërrimi i divizioni me këtë transferim është bërë me qëllim, pasi që ka që dy vite që bëhet presion i vazhdueshme ndaj saj. Kërkon të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi për transferim.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit analizoi Vendimin Nr.T-05/2025, të datës 06.01.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës në ndërlidhje me provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, nga dhe konstatoi se ankuesja është transferuar në mënyrë të përkohshëm për interes të institucionit nga pozita Inspektore Hetuese e Konkurrencës në Divizionin e Marrëveshjeve të Ndaluara në pozitën Inspektore

Hetuese e Konkurrencës në Divizionin e Analizës, Metodologjisë dhe të të Drejtave Ekskluzive, mirëpo as në dispozitivin dhe as në arsyetimin e të njëjtit akt nuk është përcaktuar kohëzgjatje e transferimit të përkohshëm. Gjegjësisht, akti i kontestuar përmban vetëm arsyetimin së ky transferim është në interes të institucionit dhe nevojës së DMT dhe së propozimin edhe vendimin për transferimin e ankueses e ka bërë drejtuesi më i lartë administrativ, respektivisht Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës. Andaj, në vlerësimin e Kolegjit, mos përcaktimit i kohëzgjatjes së transferimit i të përkohshëm sipas vendimit të atakuar është në kundërshtim me dispozitat e nenit 63 paragrafi 1, nënë paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat e Publikë, ku përcaktohet se: “63.1. Nëpunësja/i civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) vjetëve”, si dhe nenin 5 paragrafit 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil ku përcaktohet se: “2. Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit mund të propozohet nga Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i nëpunësit apo drejtuesi më i lartë administrativ i institucionit; 3. Vendimi për transferim është vendim i arsyetuar i drejtuesit më të lartë administrativ të institucionit..”

Andaj, mbi rrethanat si më sipër, Kolegji vlerëson së vendimi Nr. T-05/2025, i datës 06.01.2026, Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, konsiderohet vendim i nxjerrë në kundërshtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton: 1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm...

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.120/2026

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses G.L;
- Autoritetit të Konkurrencës: Zyrtarit Kryesor Administrativ dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore;
- Arkivit të KPMSHCK-së.